

**AKT THEMELIMI  
STATUTI I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “MA1” SHPK**

Ne baze te Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndyshuar dhe ligjit Nr. 972 dt.03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Biznesit” i ndryshuar, i nenshkruari:

- **MOSCOPOLE Inc**, një shoqeri e themeluar ne Delaware, SHBA, sipas legjislacionit te Delaware, me seli ne Hogan Lovells US LLP, 390 Madison Avenue New York. NY 10017.

Ne cilesine e themeluesit dhe ortakut te vetem te shqerise “MA1” shpk eshte vodosur te miratohet dhe nenshkruhet ky Statut i Shoqerise ne perputhje me kushtet si me poshte:

**Kreu I  
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1 – Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 5 korrik 2024, themeluesi ka krijuar shoqërine me përgjegjësi të kufizuar me emrin MA1 SHPK.

**Neni 2 – Objekti**

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Investime ne fushen e ndertimit dhe tregtimit brenda dhe jashte vendit te pasurive te paluajtshme.
- Aktivitete ne fushen e ndertimeve civile, hoteleri, sherbime, njesi shitjeje, zbatime dhe projekte, etj.
- Aktivitet ne fushen e interior-arkitekt, designer te cdo lloji.
- Shitje, blerje, financime, qiradhenie, qiramarrje, garanci, etj. qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise.
- Vleresimin e pasurive te paluajtshme, shit-blerjen me shumice dhe pakice te cdo lloj pasurie.
- Menaxhim dhe administrim pasurish te luajtshme dhe te paluajtshme;
- Mirembajtje dhe restaurim te objekteve te ndryshem.
- Per te realizuar objektin e qellimet e saj, shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar e financier, perfshire por pa u kufizuar ne sa me siper.


**Neni 3 – Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat duke filluar nga regjistrimi i saj prane Regjistrat Tregtar.

**Neni 4 – Selia**

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën “LION PARK” ne Tirane, kat 11, Hyrja 03.

2. Emertimi i shoqerise tregtare, forma ligjore, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqerise, duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga shoqeria, nepermjet shkresave te printuara apo perdonimit te mjeteve elektronike qe iu drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme.



## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
2. Ortaku themelues: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

### **Neni 6 – Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7 – Transferimi i kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b. shitblerjes;
  - c. trashëgimisë;
  - d. dhurimit;
  - e. çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.
3. Ne perputhje me parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar shitja e kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise i nenshtrohet ne cdo rast te drejtes se parablerjes nga ana e ortakeve te tjere. Per kete arsyen ortaket duhet te vene ne dijeni Administratorin e shoqerise per kushtet e shitjes te cilat do te jene te njejtë me ato që do t'i ofrohen një pale të trete. Administratori i shoqerise ka detyrimin te njoftojte ortaket e tjere me leter rekomande me perjigje duke percaktuar cmimin dhe menyrin e pageses.
4. Brenda 30 ditesh ortaket e tjere mund te vendosin te blejne kuoten që eshte ne shitje duke e njoftuar shitesin per vendimin e tyre. Nese te drejten e parablerjes deshiron ta ushtroje me shume se një ortak, secili prej ortakeve te interesuar do te realizoje blerje ne perpjestim me kuoten që ai zoteron ne shoqeri.



Nese ortaket nuk japid njoftim per blerjen e kuotes brenda 30 diteve nga kryerja e njoftimit atehere do te nenkuptohet se eshte hequr dore nga e dreja e parablejes.

5. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te behet me akt notarial dhe nje kopje e tij duhet te depozitohet ne librin e ortakeve.


### **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8 – Asambleja e Ortakeve**

1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
2. Asambleja e ortakeve eshtë përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d. emërimin e shkarkimin i likuidatoreve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për administratorret dhe likuidatoret;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin, zvogëlimin e kapitalit;
  - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m. miratimin per transferimin e kuotave tek te tretet ose Brenda shoqerise;
  - n. miraton cdo ceshtje te lidhur me pasurine e shoqerise si marrje hua, vendosje barre mbi pasurite e shoqerise etj.
  - o. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamble ne bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
4. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë.
5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9 – Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

1. Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja nuk eshtë thirrur sipas parashikimit me siper, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



### **Neni 10 – Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11 – Marrja e vendimeve**

1. Asambleja vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:
  - a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d. përcaktimin e shpërblimeve
  - e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - h. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne ekstraktin e shoqerise.

### **Neni 12 – Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja merr vendim për:
  - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 – Administrimi**

1. Asambleja emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
2. Afati i emërit të administratorit eshte 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje.
3. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
4. Administratori i parë i shoqërisë eshte

**Genti Ballta**, shtetas Shqiptar, lindur në datë 20/03/1975, në Tirane, Shqipëri, banues në Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. personal, H50320223K.

## Neni 14 – Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
  - a. kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja;
  - b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d. përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë asamblesë për miratim;
  - e. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g. raportojë përparrë asamblesë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene sipas rasteve te parashikuara ne ligj.
3. Nëse asambleja emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15 – Pergjegjesite e Administratorit

1. Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
2. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, administratori detyrohet:
  - a. të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjjed;
  - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
3. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
4. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas ligjit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë

çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

5. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV** **Viti finansiar-ekspertet**

##### **Neni 16 – Viti Financiar**

1. Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17 – Bilanci dhe Rezervat**

1. Me mbylljen e vitit finansiar, Administratorit merr masat e nevojshme per hartimin e bilencit te aktivitetit per vitin finansiar te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Pergjithsme e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundeshme te tij.
2. Asambleja e ortakeve vendos mbi ndarjen e dividendeve qe rezultojne si fitime sipas bilencit te aprovar rregulish pasi ngaketo shuma te jene zbritur humbje e mundeshme te viteve te mepareshme.
3. Asambleja ne cdo moment mund te vendose per krijimin e rezervave, dhe masen e tyre.


##### **Neni 18 – Ekspertet**

1. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

#### **Kreu V** **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 19 – Prishja dhe likuidimi**

1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:
  - a. me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - b. me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - c. nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë;
  - d. me vendim të gjykatës;



2. Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
5. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 20 – Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 21 – Baza Ligjore**

1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 22 – Mosmarrëveshjet**

1. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**O R T A K U I V E T E M  
I S H Q Ë R I S E M E P Ë R G J E G J Ë S I TË K U F I Z U A R**

**MA1 SHPK**

**MOSCOPOLE INC**

